



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREMÇABEJ"
GJIROKASTËR

Gjirokastrë, më 01/09/2016

Lënda: Hapet thirrja për pjesëmarrje në Programin Erasmus + me Universitetin e Qipros

Në kuadër të Programit Erasmus +, Universiteti i Qipros ka fituar një grant për kërkim shkencor dhe trainim në bashkëpunim me Universitetin e Gjirokastrës.

Sipas Marrëveshjes kërkohet që Universiteti i Gjirokastrës të marrë pjesë me:

- 1) një përfaqësues të stafit akademik i cili do të angazhohet në mësimdhënie për 7 ditë në Universitetin e Qipros.

Sipas Marrëveshjes, një përfaqësues i stafit akademik nga pala e Universitetit të Qipros do të angazhohet në mësimdhënie për një periudhë 7 ditore pranë departamenteve përkatëse në UGJ.

Planifikimi i aktivitetit mësimor/trainimit do të zhvillohet në vitin akademik 2016-2017 dhe gjuha e përdorur do të jetë anglisht ose greqisht në nivelin B2. Sipas të dhënave nga Universiteti i Qipros, në gjuhën angleze ofrohen disa module në Kontablitet Financë, Administrim Publik dhe në Gjuhë Angleze. Pjesa tjetër e programeve zhvillohet në gjuhën greke.

Nëse jeni të interesuar lutemi të dërgoni pranë Degës së Marrëdhënieve me Jashtë dhe Projekteve, brenda dt. 20.09.2016:

- një letër interesi e cila cilëson fushën tuaj studimore e që përshkruan ciklin e leksioneve që mendoni të zhvilloni në Universitetin e Qipros. Letra të dorëzohet në shqip dhe në anglisht,
- një CV të detajuar mundësisht në formatin EUROPASS CV në shqip dhe në anglisht,
- një provë/certifikatë të njohurive të gjuhës angleze ose greke të nivelit B2

Dokumentacioni juaj do të vlerësohet paraprakisht nga një komision Ad Hoc i ngritur pranë UGJ dhe më pas ky vlerësim do t'i përcillet palës në Universitetin e Qipros për vlerësimin përfundimtar të aplikatëve të cilët do të përzgjidhen.

Prof. dr. Bektash Mema

REKTOR